

STATUT

STATUT I SHOQËRISË "ALBORA" Sh.p.k

Ne Tirane, sot me date 30/10/2025 unë **Znj.ILIRIANA SELA**, e bija e Baudin-it, e datelindjes 29.02.1984, ne New York, Shtetet e Bashkuara te Amerikes, madhore me zotesi te plote juridike per te vepruar, e identifikuar me pasaporten me nr. A34861301, me date leshimi 30.08.2023 dhe unë **Z.ERVIN TORO**, e biri i Vladimir-it, i datelindjes 28.01.1984, ne Fier, Shqipëri, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, i identifikuar me pasaporten me nr. BD5133123 dhe nr. Personal I40128096N, me date leshimi 14.11.2023, ne cilesine e "ortakeve themelues" deklarojme se me vullnet të lire të plote e të singerte, dhe inisiativen e lire private, mbeshtetur ne Kushtetuten e Republikës së Shqiperisë dhe Kodin Civil ne fuqi, ne ligjin 9901 date 14.04.2008, "Per tregtaret dhe shoqeritë tregtare ", ligjin nr. 9723, datë 3.5.2007 "Per Qendrën Kombëtare të Regjistrimit ", ne atë Doganor, Fiskal e Tatimor, hartoj statutin e shoqerise **"ALBORA" Sh.p.k.**

KREU I

Neni 1 Krijimi

Shoqëria **"ALBORA" Sh.p.k** është person juridik i të drejtes shqiptare, Shoqëri me përgjegjesi të kufizuar (me poshte e quajtur "Shoqëria").


Neni 2 Personaliteti juridik

Shoqëria ka fituar personalitetin juridik me regjistrimin e saj ne Organet Kompetente, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqëria **"ALBORA" Sh.p.k**, është një shoqëri tregtare, e themeluar nga **Znj.ILIRIANA SELA** dhe **Z.ERVIN TORO**, te cilet nuk përgjigjen për detyrimet e shoqërisë tregtare dhe mbulojne personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara. Kontributi i ortakeve përbën kapitalin e regjistruar të shoqërisë. Ortaket gëzojne kuotën e tyre në shoqëri, në përpjesëtim me kontributin që kane dhënë në kapital.

Neni 3 Selia

Shoqëria e ka selinë ne European Trade Center – Resident Apartments , Rruga Fatmir Haxhiu, Apartmenti 14/4, Tirana 1001, Shqipëri. Shoqëria mund te ndryshoje selinë e saj, të hapë zyra perfaqësie, dege, te krijojë filiale, si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë, vetëm me vendim te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve.



STATUT

Neni 4 **Objekti i veprimtarisë**

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë është si më poshtë:

Shoqëria ka për objekt zhvillimin e veprimtarive në fushën e ndërtimit, projektimit, infrastrukturës dhe shërbimeve inxhinierike, përfshirë por pa u kufizuar në:

- Ndërtimin e objekteve civile, industriale, turistike, bujqësore dhe publike;
- Ndërtimin dhe rikonstrukcionin e rrugëve, urave, tuneleve, ujësjellësave, kanalizimeve, sistemeve të vaditjes dhe kullimit;
- Punime elektrike, hidrosanitare, ngrohje-ftohje dhe ventilimi, si dhe instalime teknologjike;
- Punime fasadash, çative, termoizolime, hidroizolime dhe mirëmbajtje objektesh;
- Punime të infrastrukturës energjetike, përfshirë ndërtimin e parqeve diellore, eolike (me erë), hidrocentraleve të vegjël dhe sistemeve të shpërndarjes së energjisë;
- Punime urbanistike, sheshe, ndriçim publik, gjelbërim, parqe dhe ambiente rekreative;
- Ndërtim, rikonstrukcion dhe mirëmbajtje të objekteve për banim, shërbime, zyra, hotele, spitale, shkolla dhe qendra tregtare;
- Projektim, mbikëqyrje, konsulencë inxhinierike, arkitektonike dhe urbanistike;
- Studime të fizibilitetit, plane zhvillimi, analiza tekniko-ekonomike dhe menaxhim projektesh ndërtimi;
- Prodhim, tregtim, import-eksport të materialeve të ndërtimit, pajisjeve elektrike, hidraulike, metalike dhe çdo materiali ndihmës;
- Blerje, shitje, administrim, dhënie me qira ose nënkontraktim të pasurive të paluajtshme dhe të pajisjeve ndërtimore;
- Kryerje të punimeve të nënkontraktuara për subjekte të tjera vendase apo të huaja
- Marrje pjesë në tendera publikë apo privatë, brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë;
- Zhvillim projektesh investuese në fushën e ndërtimit, energjisë, turizmit dhe infrastrukturës;
- Tregti me shumicë dhe pakicë e produkteve ndërtimore, inerteve, makinerive, pajisjeve dhe automjeteve ndërtimore;
- Transport i mallrave dhe materialeve ndërtimore me mjetet e veta ose me të palëve të treta;
- Veprimtari ndërmjetësimi dhe bashkëpunimi me kompani të huaja për zhvillim projektesh ndërtimi dhe investimesh infrastrukturore.

Shoqëria mund të ushtrojë çdo aktivitet tjetër që lidhet drejtpërdrejt ose tërthorazi me objektin e mësipërm, brenda kuadrit të ligjeve shqiptare, si dhe çdo aktivitet tjetër që mund të vendoset nga Asambleja e Ortakëve dhe të regjistrohet në QKB.



STATUT

Neni 5

Kohëzgjatja

Shoqeria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore pa afat.

KREU II

KAPITALI

Neni 6

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100.000 (njëqind mijë) lekë. Kapitali i mesipër është nënshkruar nga "ortaket" e shoqërisë **Znj.ILIRIANA SELA** dhe **Z.ERVIN TORO** dhe përmbetet nga 2 (dy) pjesë/ kuota me vlerë të përgjithshme 100.000 (njëqind mijë) lekë, që ndahen: **50% të kuotave ose 50.000 (Pesëdhjetë mijë) lekë për Znj.ILIRIANA SELA dhe 50% të kuotave ose 50.000 (Pesëdhjetë mijë) lekë për Z.ERVIN TORO.** Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme. Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta)

Ortakët përgjigjen për humbjet e shoqërisë përkundërt të tregjeve deri në vlerën e kontributit të tyre në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Neni 7

Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë. Zvogëlimi dhe zmadhimi i kapitalit realizohet me Vendim të Ortakëve në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.

Neni 8

Kuotat

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyrë tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim. Personat që kalojnë kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidarë ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit të saj në Qendren Kombëtare të Biznesit, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën

STATUT

Kombëtare të Regjistrimit". Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ. Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie. Transferimi i kuotave te te tretet kufizohet me miratim te asamblese se ortakevenë të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.

KREU III

ORGANET DREJTUESE DHE VENDIMMARRËSE

Neni 9

Organi Vendimmarres

Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise.

Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve eshte organi vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj. Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKB per te pasyqruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

Ortaket , vendosin për çështje si:

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- ç) përcaktimin e shpërblimeve
- d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

Të gjitha vendimet e marra nga ortaket regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat etë cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhet regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë; shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- c) investime;
- ç) vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund ti kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në m'irëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.



STATUT

Neni 10

Administrimi

Administrator i shoqërise është ortak i shoqërisë Z. ERVIN TORO, i biri i Vladimir-it, i datelindjes 28.01.1984, në Fier, madhor me zotesi të plote juridike për të vepruar, i identifikuar me pasaportën me nr. BD5133123 dhe nr. Personal I40128096N, me datë lëshimi 14.11.2023. Administratori mund të emërohet dhe shkarkohet me vendim të Asamblesë së Ortakeve të Shoqërise.

Neni 11

Kompetencat


Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, politikën tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- d) përgatis dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecërisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- e) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- f) kryejë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit,
- g) raportojë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- h) Administratori nuk mund të kryejë veprime bankare si tërheqje, depozitim, etj. pa miratimin e ortakut tjetër ZNJ. ILIRIANA SELA duke u paraqitur personalisht para çdo institucioni financiar.
- i) Administratori nuk mund të nënshkruajë apo të firmosë pa miratimin e ortakut tjetër.

Administratori është i detyruar të thërrasi mbledhjen e ortakeve edhe në rastet kur:

- a) sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim dhe
- b) kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara,

Administratori ka të drejtë të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm. Administratori përfaqëson Shoqërinë përpara të gjitha personave fizike e



STATUT

juridike, publike dhe/ose private vendas apo të huaj, autoriteteve shtetërore Shqiptare apo të huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore të gjitha shkalleve. Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimisht ortakevete shoqërisë.

Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.

Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rrethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

Neni 12 Përgjegjësitë

Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë. Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga Ortaket që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakeveqë ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare", administratori detyrohet:

- a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;
- b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
- c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
- ç) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;
- d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe ti kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja



STATUT

është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar ti dëmshpërblejë

shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit, Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare, kryen veprimet e mëposhtme:

- a) u kthen ortakëve kontributet;
- b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;
- c) u shpërndan aktivet shoqërisë;
- d) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet
- e) jep kredi.

Neni 13

Viti Financiar

Viti financiar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor.

Neni 14

Bilanci i shoqerise dhe dividendet

Brenda 6 muajsh nga mbyllja e vitit financiar, Mbledhja e Ortakeve , miraton bilancin e paraqitur nga Administratori. Mbledhja e Ortakevete vendos rreth shperndarjes se dividendit, pasi te jene zbritur humbjet e vitit te meparshem financiar, siç edhe parashikohet nga ligji.

Neni 15

Ekspertet

Eksperti ka per detyre qe te kontrolloje te gjithë dokumentacionin kontabel të veprimtarise ekonomiko tregtare të shoqerise, ate gjithëvjetor dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij per rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer nje gje të tille i ngarkuar nga ana e ortakëvetë vetem. Ne perfundim të kontrollit eksperti kontabel i autorizuar pergatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe per ate per kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar qe t'ja paraqese e dorezoje ne kohe ortakëveper t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazen e të drejtes vendimore qe ka.

Neni 16

Të ardhurat neto (Dividenti)

Të ardhurat neto (Dividenti) qe mbeten pas vecimit të fondeve ligjore të mesiperme dhe të atyre per shlyerjen e cdo detyrimi fiskal apo likuidimin e pagesave ndaj të treteve, i mbeten dhe i kalojne ne pronesi, ortakëve të shoqerise.



STATUT

Neni 17

Shperndarja ose prishja e shoqerise

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund të behet ne cdo kohe:

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të ortakevete vetem;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- d) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";
- e) me vendim të gjykatës;

Ne kete rast Ortaket marrin vendim me shkrim ne të cilin parashikon menyren e likuidimit të shoqerise, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesen shtese " Shoqeri ne likuidim e siper ". Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë pagueese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi. Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaket. Nëse Ortaket nuk marrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

Neni 18

Likuidimi

Likuiduesi merr përsipër të drejtat dhe detyrimet e administratorëve nga data e emërimit të tij. Nëse shoqëria emëron më shumë se një likuidues, përveçse kur akti i emërimit parashikon se ata veprojnë veçmas njëri-tjetrit, likuiduesit ushtrojnë bashkërisht të drejtat e detyrimet sipas këtij ligji. Likuiduesit mund të autorizojnë njërin prej tyre të kryejë veprime të një kategorie të posaçme. Kufizimet e tagrave të likuiduesve u kundrejtohen të tretëve, në përputhje me përcaktimet e ligjit. Likuiduesi u nënshtrohet mbikëqyrjes së ortakevedhe administratorit.

Neni 19

Të drejtat e detyrimet e likuiduesit

1. Detyra e likuiduesve është mbyllja e të gjitha veprimeve të shoqërisë, mbledhja e kredive të paarkëtuara dhe e kontributeve të pashlyera, shitja e pasurive të shoqërisë dhe shlyerja e kreditorëve duke respektuar radhën e referimit, sipas nenit 605 të Kodit Civil.



STATUT

2. Likuiduesi mund të kryejë edhe veprime të reja reja tregtare, për mbylljen e një veprimi të papërfunduar.
3. Nëse, në bazë të padive të ngritura nga kreditorët, sipas nenit 194 të ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare ", likuiduesit vërejnë se pasuria e shoqërisë tregtare, përfshirë kontributet e pashlyera, nuk është e mjaftueshme për pagesën e këtyre pretendimeve, likuiduesit detyrohen ta pezullojnë procedurën e likuidimit e ti kërkojnë gjykatës përkatëse nisjen e procedurave të falimentimit. Likuiduesi përgatit një bilanc të gjendjes së shoqërisë në çastin e hapjes së likuidimit dhe një bilanc përfundimtar në çastin e mbylljes së këtyre procedurave. Nëse procedura e likuidimit zgjat më shumë se një vit, likuiduesi përgatit, gjithashtu, pasqyrat financiare vjetore të shoqërisë. Bilancet në shoqërinë kolektive dhe komandite miratohen nga ortakët e tjerë, ndërsa në shoqëritë aksionare apo nga ato me përgjegjësi të kufizuar miratohen nga asambleja e përgjithshme.

Neni 20

Përfundimi i likuidimit

Pas shpërndarjes së aktiveve të mbetura, likuiduesi e njofton Qendrën Kombëtare të Regjistrimit për përfundimin e likuidimit dhe kërkon çregjistrimin e shoqërisë, në përputhje me seksionin V të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit".

Neni 21

Bashkimi

Dy ose më shumë shoqëri mund të bashkohen nëpërmjet:


1. Kalimit të të gjitha aktiveve e pasiveve të njëres ose ose më shumë prej shoqërive, që quhen shoqëritë e përthithura, të një shoqëri tjetër ekzistuese, e quajtur shoqëria përthithëse, në këmbim të aksioneve apo kuotave të kësaj shoqërie. Ky proces quhet bashkim me përthithje.
2. Themelimit të një shoqërie të re, tek e cila kalohen të gjitha aktivet e pasivet e shoqërive ekzistuese, që bashkohen në këmbim të aksioneve apo kuotave të shoqërisë së re. Ky proces quhet bashkim me krijim i një shoqërie të re.

Neni 22

Ndarja

Një shoqëri mund të ndahet me vendim të Ortakeve , duke transferuar të gjitha aktivet e pasivet e veta në favor të dy ose me shumë shoqërive ekzistuese apo të themeluara rishtazi. Shoqëria që ndahet, vlerësohet e prishur. Për ndarjen e shoqërisë zbatohen përkatësisht dispozitat e neneve 216 deri në 225 të ligjit 9901 date 14.04.2008. Shoqëritë, që fitojnë pasuritë e shoqërisë që ndahet, quhen shoqëri pritëse dhe përgjigjen në mënyrë solidare për detyrimet e kësaj të fundit.

Regjistrimi i ndarjes së shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit ka si pasojë:



STATUT

- a) kalimin te shoqëritë pritëse të të gjitha aktiveve e pasiveve të shoqërisë që ndahet, në përputhje me raportin e ndarjes, të përcaktuar në marrëveshjen e ndarjes. Ky kalim sjell pasoja për marrëdhëniet ndërmjet shoqërive, si dhe për palët e treta
- b) bërjen e aksionarëve/ortakeve të shoqërisë që ndahet aksionarë apo ortakë të një ose më shumë shoqërive pritëse, në përputhje me raportin e ndarjes, përcaktuar në marrëveshjen e ndarjes;
- c) vlerësimin e shoqërisë që ndahet si e prishur dhe çregjistrimin e saj nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit, sipas seksionit V të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" pa kryerjen e likuidimit.

Neni 23 Shndërrimi

Shoqëria mund ta ndryshojë formën e vet ligjore, nëpërmjet shndërrimit te saj në shoqëri aksionare. Shndërrimi nuk sjell pasoja mbi të drejtat e detyrimet, që shoqëria ka marrë përsipër ndaj të tretëve.

Neni 24 Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje të plote me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar. Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 25 Mosmarreveshjet

Për mosmarreveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarreveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare.

Neni 26 Dispozita përfundimtare

Ky Statut u redaktua në 3 ekzemplare me vlera të njëjta juridike në gjuhën shqipe dhe nënshkruhet me vullnetin e tij të lire nga ortakët themelues të Shoqërisë.

ORTAKËT E SHOQËRISË "ALBORA" Sh.p.k

Znj.ILIRIANA SELA



Z.ERVIN TORO

